



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

BULETINI

**I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË
KONKURSIN PËR AVANCIMIN / RIEMËRIMIN E
PERSONELIT AKADEMIK Nr. 01-18 TË DATËS 09.02.2020
PËR KONKURS PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE
AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK**

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe:

1. Është anuluar

2. Referat për zgjedhjen e një (1) Mësimdhënës për lëndët (avancim / riemrim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) : Hyrje në shkencën e letërsisë, Teoria e letërsisë, Letërsi romantike shqipe I, Letërsi romantike shqipe II, Letërsi moderne I, Letërsi moderne II.

1. Teuta Vinca Kafexholli

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze:

1. Referat për zgjedhjen e një (1) Mësimdhënës për lëndët (avancim / riemrim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) : Përkthim anglisht-shqip, Përkthim shqip-anglisht, Teori i përkthimit, Të nxëniet e gjuhës së parë dhe të dytë, Gjuhë dhe kulturë, Idiomatikë e gjuhës angleze.

1. Sejdi Sejdiu

2. Referat për zgjedhjen e një (1) Asistent për lëndët (riemrim në përputhje me nenin 174 të Statutit) : Shkathtësitë e integruara I, Fonetikë dhe fonologji, Morfologji e gjuhës angleze, Sintaksë e gjuhës angleze I, Sintaksë e gjuhës angleze II, Anglishte për qëllime akademike I.

1. Dorinë Rakaj

2. Kujtesa Tytynxhiu

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane:

1. Referat për zgjedhjen e një (1) Mësimdhënës për lëndët (avancim / riemrim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) : Gramatika e gjuhës gjermane I, Gramatika e gjuhës gjermane II, Morfologji e gjuhës gjermane, Hyrje në didaktikën e gjuhëve të huaja, Metodika dhe didaktika e gjuhës gjermane II, Seminar i didaktikës.

1. Kimete Canaj

UNIVERSITETI I PRIZRENIT "UKSHIN HOTI"

FAKULTETI I FILOLOGJISË



RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK

Kandidatja e paraqitur:

1. Teuta Vinca Kafexholli

Lëndët: *Hyrje në shkencën e letërsisë; Teori e letërsisë; Letërsi romantike shqipe I; Letërsi romantike shqipe II; Letërsi moderne I; Letërsi moderne II.*

Të dhënat për kandidaten:

Emri dhe mbiemri:	Teuta Vinca Kafexholli
Datëlindja dhe vendi i lindjes:	04.10.1963, Strugë
Shkollimi superior:	Doktore e shkencave filologjike
Grada shkencore:	Dr. sc.
Titulli akademik:	Prof. ass.
Viti kur është fituar titulli aktual:	2017
Departamenti - Fakulteti:	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe - Fakulteti i Filologjisë
Universiteti:	Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"

Komisioni recensues:

1. Kryetar: Prof. dr. Sali Bashota
2. Anëtare: Prof.asoc.dr. Myrvete Dreshaj Baliu
3. Anëtar: Prof.asoc.dr. Shkëlqim Millaku

Three handwritten signatures in blue ink are written over horizontal lines. The first signature is the largest and most prominent, followed by two smaller ones below it.

UNIVERSITETI I PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”

Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti: Profesoreshë e asocuar

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor - Kontributi shkencor:

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatës, të cilët tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së saj shkencore

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me “impact faktor” si autor kryesor*	2	2
Numri i publikimeve në revistat me “impact faktor” si koautor**	-	1
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa “impact faktor” si autor kryesor*		
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	14	5
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	10	3
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	7	2
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	5	1
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	-	-

UNIVERSITETI I PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”

Punimet relevante të kandidatës:

Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatës të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar..

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	“Impact factor”	Nr. i citimeve
<p>Teuta Vinca Kafexholli: “Një prozë e rrallë në letërsinë tone”, Gjurmime albanologjike, IAP, 2020, Seria e shkencave filologjike, Prishtinë</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “ Dy parathënie të veprës “Këngë e brithma nga qyteti i djegur” që zgjojnë interes shkencor”, Gjurmime albanologjike, IAP, 2020, Folklor dhe etnologji, Prishtinë</p> <p>Teuta Kafexholli: “Some Values of the First Folklore Work with Scientific Criteria”, Journal of Literature, Languages and Linguistics www.iiste.org ISSN 2422-8435 An International Peer-reviewed Journal Vol.72, 2020, https://iiste.org/Journals/index.php/JLLL/article/view/54531abstrakt https://iiste.org/Journals/index.php/JLLL/article/view/54531/56451 DOI: 10.7176/JLLL/72-06 Publication date:October 31st 2020_(Ebsco, Eric, WorldCat)</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli & Xhevahire Millaku: “The Narrative and Sublime in the Kutilian fiction”, Konferencë shkencore ndërkombëtare e Universitetit të Sofjes “Sv. Kliment Ohridski”, https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3380965 https://www.worldcat.org/search?qt=worldcat_org_all&q=teuta+kafexholli https://ssrn.com/abstract=3380965 or http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3380965 Sofje, 2019.; (WorldCat)</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Bota e fëmijëve në kohë pandemie (recension)”, Recension për veprën e SabileBasha Keçmezi “Nëkohë pandemie nipat e mi s’ dalin prej shtëpie”, Pr., 2020, https://www.epokaere.com/bota-e-femijeve-ne-kohe-pandemie/ ISBN 978- 9951-779-06-7, “Epoka e Re”, Prishtinë, nëntor 2020.</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Aspekte gjuhësore në prozën kuteliane”, Konferencë gjuhësore në Universitetin e Prizrenit, ISBN 978-9951-767-26-2, 6 maj 2019, Prizren, 2019, f.65.</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Fakti dhe fikcioni në plan krahasues mes tre shkrimtarëve dhe tri regjioneve gjuhësore ballkanike”, Seminari XXXVI Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2017, f.233. ISSN 2521-3679 https://filologjia.uni-pr.edu/getattachment/Seminari/Programi-i-Seminarit-XXXVI-(me-abstrakte)-varianti-i-fundit.pdf.aspx</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Disa aspekte të rëndësishme nga trashëgimia jonë letrare në një parafjalë”, Internacional Conference on Linguistics Literature and Culture BOOK OF PROCEEDINGS ISBN 978-9951-494-62-5 http://aab-edu.net/assets/uploads/2017/01/Book-of-proceedings_layout.pdf Icllc; 18 June 2016, 423.</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Një aspekt i poezisë së Mitrush Kutelit në plan</p>		

UNIVERSITETI I PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”

<p>krahasues”, Java e shkencës , MASHT, ISBN 978-9951-16-090-2). 2015. Kumtesa I. 23.</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Letëria në revistën “Shejzat”, Java e Albanologjisë, Instituti albanologjik, ISBN 987-9951-596-7, 2015, Albnologjia 5, vëllimi I, 139.</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: ” Afirmimi i arsimit dhe kulturës në një vepër të rëndësishme”, Java e shkencës , MASHT, ISBN 978- 9951-16-088-9. 2014, Kumtesat I, 699. http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/agjenda-perfundimtare.pdf</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Kronotopi si nocion sipas studiuesve”, Java e shkencës, MASHT, 2013, Kumtesat I, 630. http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/kumtesat-2013-libri1-perfundimtar-botim-elektronik-2.pdf</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Koha, një fenomen i pranishëm në letërsi”, studim, 2013. “Kosova sot”, 8 qershor, 34.</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Për Mitrush Kutelin dhe konstatimet e tij për këngët folklorike”, Java e shkencës , MASHT, 2012, Kumtesa, 315. http://masht.rks-gov.net/kumtesat-e-konferences-java-e-shkences</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: ” Mitrush Kuteli si folklorist”, Gjurmime albanologjike, IAP, 2010, Folklor dhe etnologji, 40, 325. http://www.bksh.al/adlib/scripts/wwwopac.exe?DATABASE=catalo&OPAC_URL=/adlib/beginner/index_al.html&LANGUAGE=1&%250=200267470&LIMIT=0</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Mitrush Kuteli poet”, Gjurmime albanologjike, IAP, 2008, Seria e shkencave filologjike 38, 292. https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=231470</p> <p>Teuta Vinca Kafexholli: “Këngë e britma nga qyteti i djegur si vepër e parë në fushën e folklorit me kritere shkencore”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, 1995; Bujku 16 dhjetor `95,7.</p>		
<p>LIBRA – MONOGRAFI</p>		
<p>“Vështrim sinjifikativ i një proze të rrallë” Studim monografik, Artini, Prishtinë, 2021, ISBN 978-9951-803-70-0</p> <p>“Kronotopi në prozën `E madhe është gjëma e mëkatit” Studim monografik, Buzuku, Prishtinë, 2014, ISBN 978-9951-675-16-1.</p> <p>“Antologji e penave të reja”, ASK, Prishtinë, 2013, ISBN 978-9951-8875-0-2.</p> <p>“Veshtare moj...” (me parathënie dhe 132 këngë të llojeve të ndryshme), Iris, Strugë, 2012, ISBN 978- 608- 207- 079-7.</p> <p>“Mitrush Kuteli si folklorist dhe poet”, studim monografik, Iris, Strugë, 2008, ISBN 978- 9989- 114-89-7.</p>		
<p>E përfaqësuar në veprën “Gra të njohura të trojeve shqiptare”, të autores Hanëmshahe Ilazi, Koha, Prishtinë, ISBN 978-9951-685-25-2, 2015, f.306.</p>		

UNIVERSITETI I PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”

TRAJNIME/ ZHVILLIME PROFESIONALE		
Certificate: For completion of professional development, 2013 Certificate of participation in the workshop on the 4 pillars of literacy, 2009 Certificate: Participant of the learner centered instruction program (Education Development Association), 2008 Participation award- inspiring teacher CERTIFIKATE, KEDP, Participant of the Learner Cenred Instuction Program, 2007/2008 Certificate of attendance: Has successfully attended training on GOING ONLINE, 2006		

2. Përvoja në mësimdhënie universitare:

Kandidatja prof.ass.dr. Teuta Vinca Kafexholli ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie. Si profesoreshë e rregullt duke marrë titullin profesor asistent në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” prej 13.01.2017 me lëndët në fushën e letërsisë: Hyrje në shkencën e letërsisë, Teori e letërsisë, Letërsi romantike shqipe, Letërsi moderne. Në këtë universitet ka filluar të ligjërojë prej vitit 2014 si profesoreshë e angazhuar.

Tetor 2015- Universiteti AAB, ligjëruese në lëndët: Morfologji dhe ortografi e gjuhës shqipe, Gjuhë amtare, Sintaksë e gjuhës shqipe, Komunikim biznesi (niveli master).

Tetor 2013-2015- Kolegji i menaxhmentit internacional “GLOBUS”, ligjëruese (me angazhim) në lëndët: Shkrim akademik- Shkathtësi në shkrimin e raporteve profesionale.

Tetor 2012-13- Universiteti i Prishtinës- Fakulteti i Edukimit ligjëruese (me angazhim) në lëndën Shkrim akademik.

Shkurt 2012-2016-Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik. Ligjëruese (me angazhim) në lëndën Kulturë gjuhe dhe Shkrim akademik.

Tetor 2009-2013-Kolegji Victory. Ligjëruese (me angazhim) në lëndët: Shkrim akademik I dhe II, Shkrim biznesi.

Shtator 2005-2014-Ligjëruese në UNITED WORLD COLLEGE- Singapur-Mostar. Profesor në distancë (Self Taught Albanian A Generation).

Shtator 2004-2014- Profesor në American School of Kosova, Prishtinë.

Gjithashtu, ka punuar profesoreshë në shkollën e mesme “Sami Frashëri” në Prishtinë, si dhe në shkollën e mesme “Ali Sokoli” në Prishtinë.

3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim:

Prof.ass.dr. Teuta Vinca Kafexholli ligjëron në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” që nga themelimi i Fakultetit të Filologjisë, Dega Gjuhë dhe letërsi shqipe më 2014, ndërsa nga viti 2017 është mësimdhënëse e rregullt në këtë fakultet. Ka marrë pjesë në shumë simpoziume shkencore, trajnime, seminare kulturore, organizime të përvjetorëve të shkrimtarëve të njohur, etj.

Në kuadër të universitetit jep kontributin e pakursyer, si: anëtare e komisionit për hartimin e Planit Strategjik të Fakultetit të Filologjisë; anëtare e komisionit për rishikimin dhe plotësimin e Rregullores së Fakultetit të Filologjisë; anëtare e komisionit për përgatitjen e programit për akreditim Gjuhë dhe letërsi shqipe; anëtare e këshillit organizues, shkencor e botues të konferencës shkencore për nder të jetës dhe veprës së prof.dr. Abdullah Zymberit; anëtare e komisionit recensues për staf të rregullt dhe të angazhuar; mentore e një numri të madh të punimeve të diplomës në kuadër të Degës së Gjuhës dhe letërsisë shqipe; kryetare e komisionit si dhe anëtare në mbrojtjen e temave të diplomës; anëtare e Këshillit të librit në MRKS; anëtare e komisionit për ankesa, etj.

4. Mobiliteti i kandidatës:

Prof.ass.dr. Teuta Vinca Kafexholli në janar të vitit 2012 ka marrë titullin doktor i shkencave filologjike në Universitetin Publik “Shën Kirill Metodi” të Fakultetit Filologjik “Bllazhe Koneski” të Shkupit. (Njohja dhe baraspeshimi i gradës nga MASHT-i, nr.6/3965). Në vitin 2008 merr titullin magjistër i shkencave filologjike në Universitetin e Prishtinës. Fakultetin Filologjik e kryen në Universitetin e Prishtinës më 1989, duke marrë titulli profesor i letërsisë dhe gjuhës shqipe.

5. Titulli i cili propozohet:

Kandidatja Teuta Vinca Kafexholli, me titull akademik prof.ass., propozohet për zgjedhje në **thirrjen profesorëshë e asocuar** për lëndët mësimore: *Hyrje në shkencën e letërsisë, Teori e letërsisë, Letërsi romantike shqipe I, Letërsi romantike shqipe II, Letërsi moderne I, Letërsi moderne II.*

UNIVERSITETI I PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”

Përfundim


Mbështetur në nenin 172, pika 1, 1.1, 1.2, 1.4, 1.5 të Statutit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe pika 2 dhe 3 e nenit 5 të mbështetur në rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të UPZ, kandidatja prof. ass.dr. Teuta Vinca Kafexholli, i plotëson të gjitha kushtet e parapara sipas Konkursit për avancim/riemërim të personelit akademik nr. 01/18 të datës 11.01.2021.

Kandidatja në fjalë ka përvojë të gjatë në mësimdhënie, duke dëshmuar punë të suksesshme pedagogjike në procesin e mësimdhënies në lëndët e letërsisë.


Bazuar në të dhënat e paraqitura më lart _____, Komisioni recensues vlerëson se prof. ass. dr. Teuta Vinca Kafexholli, i plotëson të gjitha kushtet juridike, administrative dhe profesionale të parapara në konkurs, prandaj i propozon Senatit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, që prof. ass. dr. Teuta Vinca Kafexholli, **të avancohet** në thirrjen **profesoreshë e asocuar**, në lëndët mësimore: *Hyrje në shkencën e letërsisë, Teori e letërsisë, Letërsi romantike shqipe I, Letërsi romantike shqipe II, Letërsi moderne I, Letërsi moderne II.*

Nënshkrimet e komisionit recensues:


1. Kryetar: Prof. dr. Sali Bashota



2. Anëtare: Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj Baliu



3. Anëtar: Prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku



Prizren, më 11.03.2021

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti i Filologjisë



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar nga:	15.05.2021
Zyra e pranimit:	141 i protokollit
308	02-99

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES
PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK**

Raporti i recensionit

Fakulteti: Fakulteti i Filologjisë
Lënda/ët: Përkthim anglisht-shqip; Përkthim shqip-anglisht; Teori e përkthimit; Të nxënit e gjuhës së parë dhe të dytë; Gjuhë dhe kulturë; Idiomatikë e gjuhës angleze
Kandidati: Prof.ast.dr. Sejdi Sejdiu

1.Të dhënat për kandidatin:

Emri dhe mbiemri: Sejdi Sejdiu
Datëlindja dhe vendlindja: 07.07.1979 Prishtinë, Kosovë
Gradat shkencore: Doktor i Filologjisë (në Universitetin e Klagenfurtit, Austri, Fakulteti i filologjisë, nr. L792-343). Barasvlerësimi i diplomës së doktoraturës nga MASHT-i, nr.6/877. Master i Shkencave Filologjike (në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Filologjisë – në fushën e gjuhës angleze, nr. 34), Profesor i Gjuhës dhe i Letërsisë angleze (në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Filologjisë – dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, nr. 887).

Titujt akademikë: Profesor asistent
Viti kur i është dhënë titulli: 2015
Departamenti/fakulteti: Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë angleze, Fakulteti i Filologjisë
Universiteti: Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Komisioni recensues:

1. Kryetar Prof. Dr. Agim Poshka
2. Anëtar Prof. Asoc. Dr. Arta Toçi
3. Anëtar Prof. Asoc. Dr. Izer Maksuti

Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti: Profesor i asocuar (Prof.asoc.)

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti i Filologjisë

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit Prof. ast.dr. Sejdi Sejdiu

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm tëpunimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë originalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore.

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor*	7	6
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor**	2	1
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor*	5	6
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor**	5	0
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor	6	4
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	4	2
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	8	4
Numri i abstrakteve nga konferencatshkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	6	6
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	1	1
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	0	0
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	0	0
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike	4	4

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti i Filologjisë

Punimet relevante të kandidatit Prof.ast.dr. Sejdi Sejdiu

Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit të cilat tregojnë originalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët/Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	Pa "Impact factor" "	Nr. i citimeve
1. Sejdi Sejdiu: Global languages vs. local languages in the era of globalization. The International Journal of Communication and Linguistic Studies. The Learner Common Ground Research Networks, <i>Volume 18</i> , Issue: 2 <i>Year: 2020</i> ; University of Illinois Research Park, 2001 South First Street, Suite 202, Champaign, IL 61820 USA	ISSN: 2327-7882 (Print) ISSN: 2327-8617 (Online)	
2. Sejdi Sejdiu: Human learning process with technologies. Balkanistic Forum, Volume 3/2018, 230-240	ISSN: 1310-3970 (Print) ISSN: 2434-1265 (Online)	1
3. Sejdi Sejdiu: Code-switching of born bilingual Albanian-English children from zero to four years of age. The International Journal of Early Childhood Learning. Common Ground. The Learner Common Ground Research Networks, Volume 24, Issue 3, year 2018. University of Illinois Research Park, 2001 South First Street, Suite 202, Champaign, IL 61820 USA	ISSN: 2327-7939 (Print) ISSN: 2327-8722 (Online)	1
4. Sejdi Sejdiu: Are Listening skills best enhanced through Multimedia technology? Digital Education Review. University of Barcelona. Number 32, December 2017	ISSN: 2013-9144	16
5. Sejdi Sejdiu: Impact of Globalization on Language Status and Development. Open Education as a way to knowledge society. 195-201. Centre for Higher Education studies, Prague, June 2017	ISBN: 978-80-86302-82-9	
6. Sejdi Sejdiu: Media Literacy Education Tool for Knowledge Society. Open Education as a way to knowledge society. Centre for Higher Education studies, Prague, June 2017	ISBN: 978-80-86302-82-9	

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti i Filologjisë

7. Sejdi Sejdiu: Do bilinguals outperform monolinguals? Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences, Vol. 2, No. 3, November 2016	E-ISSN: 2410-8693 ISSN: 2410-3918	
8. Sejdi Sejdiu: Should the UK's Evaluation System of Learning Change at Primary and Secondary Schools? The International Journal of Educational Organization and Leadership, Illinois, USA, shkurt 2015; vëllimi 21, numri 2, 13 faqe.	ISSN 2329 1656	
9. Sejdi Sejdiu: Language Teaching and Assessment in Blended Learning, JoTLT, Indianapolis, USA, dhjetor 2014, vëllimi IX, 27 faqe.	ISSN: 2165-2554	11
10. Sejdi Sejdiu: The effect of MMB Instruction on the Development of Listening Competencies, DisCo 2014, Centre for Higher Education Studies, Charles University, Prague, Czech Republic, korrik 2014, vëllimi IX, 14 faqe.	ISBN 987-80-86302-45-4	
11. Sejdi Sejdiu: Review of the Evaluation Policies in the Primary and Secondary Schools, ICRAE; Shkodër, Shqipëri, qershor 2014, vëllimi II, nr. 2, 11 faqe.	ISSN: 2308-0825	
12. Sejdi Sejdiu: The impact of multimedia technology on developing L2 listening skills, ICRAE; Shkodër, Shqipëri, shtator 2013, vëllimi I, nr. 1, 8 faqe.	ISSN: 2308-0825	2

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren Fakulteti i Filologjisë

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

Më 25 shkurt të vitit 2006 kandidati diplomoi në studimet themelore me program katër vjeçar në degën e gjuhës dhe të letërsisë angleze të fakultetit të filologjisë dhe iu dha thirrja shkencore **Profesor i gjuhës dhe i letërsisë angleze** nga Universiteti i Prishtinës. Më 3 qershor të vitit 2011, kandidati diplomoi në studimet pasuniversitare në degën e gjuhës angleze të fakultetit të filologjisë dhe iu dha thirrja shkencore **Master i Shkencave Filologjike në fushën e gjuhës angleze** në fakultetin e filologjisë se Universitetit të Prishtinës. Më 4 nëntor 2014, kandidati diplomoi në studimet e doktoratës dhe iu dha thirrja shkencore **Doktor i filologjisë** në fushën e gjuhës angleze në Universitetin e Klagenfurtit në Austri. Universiteti i Klagenfurtit e botoi disertacionin e doktoratës së kandidatit 'The Effect of MMB Instruction on the Development of listening Competencies in primary school students' si monografi e cila është e qasshme në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë, si dhe në Bibliotekën Universitare të Universitetit të Klagenfurtit.

Nga viti 2015, kandidati ka punuar si mësimdhënës në programin e Gjuhës dhe Letërsisë angleze të Fakultetit të Filologjisë në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren. Ai poashtu ka punuar pesë vjet si mësimdhënës i Gjuhës angleze në Kolegjin AAB. Kandidati ka përvojë të gjatë në mësimdhënie të gjuhës angleze në institucione publike dhe private. Ai është përkthyes dhe interpret me licencë nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës. Kandidati ka licencë të ekzaminimit nga "Pearson Test of English" dhe gjithashtu është i angazhuar në agjencinë EAQUALS në Londër e cila ofron akreditimin dhe licensim për institucione që ofrojnë gjuhë angleze. Ai poashtu ka shërbyer si ekspert për akreditim, licensim dhe validim në nivel kombëtar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve. Kandidati posedon edhe certifikatë nga Kombet e Bashkuara për kryerjen me sukses të 'English Language Proficiency Exam'.

Ka ndjekur trajnime specializimi të ndryshme të organizuara nga The British Council, Prishtinë; EAQUALS, Londër; IELTS, Prishtinë, Pearson Test of English, Prishtinë, OKB, Prishtinë, etj. Gjatë përvojës së tij në mësimdhënie, kandidati ka ligjëruar këto lëndë: *Shkathtësitë e integruara I dhe II, Anglishtja për qëllime specifike I dhe II, Gjuhë angleze I, Gjuhë Angleze II, Gjuhë Angleze III, Praktikë përkthimi ang/shq dhe shq/ang, Morfologji, Anglishte për qëllime akademike, Fonetikë dhe Fonologji, Shkathtësi komunikimi dhe prezantimi, Teoritë e të mësuarit të gjuhëve* etj.

Ai poashtu ka ka përvojë si mësimdhënës në nivelin Master dhe ka mentoruar kandidatë në tezat e tyre në Kolegjin AAB në Prishtinë. Kandidati ka marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Filologjisë

ndërkombëtare dhe ka të botuara mjaft punime shkencore si autor dhe bashkëautor në revista prestigjioze ndërkombëtare.

Në rrafshin profesional, ai është vlerësues dhe editor (Reviewer & Senior Associate Editor) i punimeve shkencore të studiuesve ndërkombëtarë në revistën shkencore 'Common Ground Publishing, The Learner, University of Illinois at Urbana-Champaign', Amerikë.

3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

Gjatë përvojës si Profesor Asistent, kandidati ka shërbyer si Prodekan i Fakultetit të Filologjisë për një periudhë dy vjeçare e gjysmë. Kandidati ka hartuar programin e ri studimor për degën e Gjuhës dhe Letërsisë angleze dhe si bartës kryesor, ka arritur të akreditojë programin me sukses në vitin 2017 për një periudhë katër vjeçare. Kandidati ka luajtur rol kyq edhe në akreditimin institucional të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, ku së bashku me një grup mësimitdhënësish të tjerë kanë arsyetuar me profesionalizëm dhe më përvojë akreditimin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, në maj të vitit 2020. Përveç detyrave akademike, kandidati ka udhëhequr komisione tejet të rëndësishme në Fakultetin e Filologjisë si psh: komisionin për sigurimin e cilësisë, komisionin për masa disiplinore, komisionin për punësimin e personelit akademik të angazhuar, si dhe anëtar i komisionit për shkencë, komisionit për studime në nivel fakulteti, komisionit për transfere, komisionit për pranimin e studentëve të rinj, komisionit të studimeve në nivel universiteti, komisionit të etikës në nivel universiteti, komisionit për hartimin e rregullores për mobilitete në kuadër të universitetit, komisionit për hartimin e rregullores kundër plagjiaturës, komisionit për akreditim institucional, etj.

Në tri vitet e fundit, ai ka arritur të sigurojë një ligjërues dhe një asistente amerikane për çdo vit akademik fal bashkëpunimit të tij të ngushtë me Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë. Kjo arritje e kandidatit ka bërë që cilësia e studimeve të rritet dukshëm si pasojë e ligjëruesve amerikanë. Në vitin 2017 ai ka krijuar laboratorin e gjuhës angleze përmes projektit 'Teacher Training Support Facility and Resources' të fituar nga Ambasada e SHBA-ve, që u ka ndihmuar studentëve dhe mësimitdhënësve të programit të Gjuhës dhe Letërsisë angleze që të rrisin cilësinë e mësimitdhënies dhe mësimitdhënies.

Ajo çka spikat tek kandidati është shkathhtësia, profesionalizmi, rrjeti i gjerë dhe përvoja në projekte hulumtuese në bashkëpunim me universitete të tjera vendore dhe ndërkombëtare. Numri i madh i projekteve të fituara nga ai, pasqyron profesionalizmin e tij dhe dëshirën për t'u

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Filologjisë

zhvilluar individualisht si dhe kolektivisht duke përfshirë në projekte mësimdhënës të tjerë të universitetit dhe duke ndikuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të universitetit. Vlen të theksohet se ai në disa projekte është emëruar menaxher projekti, koordinator projekti, udhëheqës projekti, etc. Projektet në të cilat kandidati ka marrë pjesë apo tani merr pjesë i kemi shënuar më poshtë:

1. Projekti: The Community Engagement Exchange Program (CEE) 2021 Participant Selection Committee. IREX. Department of State. Washington DC. 2021, në të cilin kandidati ka shërbyer si ekspert i vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në programin për mobilitete të Departamentit të Shtetit Amerikan. Ekspertiza dhe profesionalizmi i kandidatit në këtë projekt është shpërblyer me një certifikatë nga Departamenti i Shtetit Amerikan.
2. Projekti: "Youth Employment analysis in the Western Balkans" in partnership with Wisdom College University and in collaboration with experts from Western Balkans countries, under the guidance of the Regional Cooperation Council (RCC), 2021, në të cilin kandidati ka shërbyer si ekspert nga Kosova në studimin e punësueshmerisë së studentëve dhe të rinjve në përgjithësi.
3. Projekti: Quality development of international cooperation and project management / QUADIC in the Erasmus +, 2019-2022, në të cilin kandidati është menaxher i projektit për Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. Ky është projekt i madh i programit Erasmus+ të Bashkimit Evropian, ku marrin pjesë 18 universitete në një konsorcium që ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të universiteteve në shkrimin e projekteve, themelimin dhe funksionalizimin e zyreve për bashkëpunim ndërkombëtar dhe të zyreve të projekteve, si dhe ndërkombëtarizimin e universiteteve.
4. Projekti: Multi-task, Multilingual, Multi-modal Language Generation (Multi3Generation) CA 18231, 2019-2022, projekt i COST Actions i Bashkimit Evropian që ka për qëllim hulumtimin e gjeneratës shumëgjuhësore në Evropë, e në të cilin kandidati është pjesëmarrës aktiv.
5. Projekti: Multi-disciplinary innovation for social change (SHIINE) CA 18236, 2019-2022, poashtu projekt i COST Actions i Bashkimit Evropian që ka për qëllim inovacionin multi-disiplinar për ndryshim shoqëror, e në të cilin kandidati është pjesëmarrës aktiv.
6. Projekti: European network for Web-centred linguistic data science CA 18209, 2019-2022, projekt i COST Actions i Bashkimit Evropian që ka për qëllim themelimin e rrjetit

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

Fakulteti i Filologjisë

për të dhëna gjuhësore të ofruara përmes internetit, e ku kandidati është pjesëmarrës aktiv.

7. Projekti: Capacity building in international relations and project writing, HERAS, 2018-2019, projekt i HERAS-it kishte për qëllim ngritjen e kapaciteve për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për shkrimin e projekteve, ku kandidati ishte koordinator i projektit për universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren.
8. Projekti: Teacher Training Support Facility and Resources, i fituar nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë. Kandidati ka arritur që përmes këtij projekti të krijojë laboratorin e gjuhës angleze i cili u ka ndihmuar studentëve të përgatiten për praktiken e mësimdhënies së gjuhës angleze në shkolla fillore dhe të mesme.

4. Mobiliteti i kandidatit

Kandidati Sejdi Sejdiu ka ndjekur programin Fulbright në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga gushti deri në dhjetor të vitit 2019, dhe ka fituar titullin Post Doc. Siç dihet, programi Fulbright ofrohet nga qeveria e SHBA-ve për kandidatët më të spikatur në fusha të caktuara, andaj, kandidati ka kaluar me sukses të gjitha format e vlerësimit dhe me sukses ka ndjekur studimet e post-doktoratës në Universitetin Drake të Iowa-së, si studiues i programit Fulbright. Si hulumtues në Fulbright, kandidati ka arritur të shkruajë një libër për qasjen CLIL ‘Roadmap to Content and Language Integrated Learning implementation’, për të cilën Universiteti Drake ka shkruar një recension të hollësishëm duke e vlerësuar librin dhe përvojën e kandidatit në Universitetin Drake si studiues i programit Fulbright. Libri e tij është pranuar të botohet nga shtëpia botuese Springer, shtëpia më prestigjioze në Evropë, që vërtetohet në shkresën e saj.

Një letër urimi për përzgjedhjen në programin Fulbright, kandidati e ka pranuar edhe nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z.Donald Trump. Certifikata e përfundimit të programit Fulbright është arritje jashtëzakonisht e madhe për kandidatin dhe për Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren.

Pas përfundimit të programit Fulbright, kandidati ka pranuar një letër nga drejtoresha e programit Fulbright, znj.Greta Scharnweber, e cila, në letrën e saj e fton kandidatin për bashkëpunim në të ardhmen.

Një mobilitet tjetër poashtu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kandidati e ka zhvilluar në vitin 2017 si pjesëmarrës i përzgjedhur nga Departamenti i Shtetit amerikan për të ndjekur programin Open World të qeverisë amerikane. Dëshmitë vërtetojnë se kandidati ka zhvilluar

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

Fakulteti i Filologjisë

takime të rëndësishme me zyrtarë, ambasadorë dhe diplomatë të shtetit amerikan, si me Kongresmenim Eliot Engel, me senatorin e Nju Jorkut Neil Breslin, si dhe ka qënë i ftuar në Kongresin amerikan, ne Shtëpinë e Bardhë, dhe ka vizituar një numër universitetesh e kolegjesht amerikane për të themeluar bashkëpunim në fusha të ndryshme.

Kandidati, si anëtar i European Association for International Education, ka ndjekur takime e seminare të ndryshme me qëllim të ngritjes së cilësisë së studimeve, si dhe është shprehur vullnetar për të marrë pjesë në programin e mentorimit të EAIE-së.

Një vizitë pesë ditore kandidati e ka zhvilluar në Universitetin e Salzburgut në Austri në qershor të vitit 2017, në cilësinë e koordinatorit të projektit të HERAS-it ‘Capacity building in international relations and project writing’, i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, ku ndërkombëtarizimi i programeve studimore dhe menaxhimi i projekteve kanë qënë tema kryesore të agjendës.

Ai shpesh është ftuar në konferenca në vende të ndryshme ku ka mbajtur ligjërata lidhur me fushën e gjuhësisë. Vlen të theksohen ftesat nga Universiteti Charles në Pragë të Çekisë; konferencën e ISIRC 2020 Social Innovation and higher education institutions' policy labs, e mbajtur nga 1-3 shtator 2020, në Sheffield të Anglisë; konferencën e nëntë Euroaziatike për gjuhën dhe shkencat sociale në Turqi; konferencën Bridges to Success – MIDTESOL19, Mid America Teachers of English to Speakers of other languages, të mbajtur më 27 dhe 28 shtator 2019 në Omaha të Nebraskës, SHBA; konferencën Education for the Future – Strengthening cooperation among Kosovo Higher Education Institutions, government and private sector, të organizaur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë, e mbajtur më 26-27 prill 2018, në Prishtinë.

Gjatë përvojës së tij, kandidati ka qënë i ftuar në EAQUALS për të ndjekur konferencën për vlerësimet sipas CEFR. Në Universitetin e Klagenfurtit gjatë studimeve të doktoratës ka mbajtur tri ligjërata si: Cutting Edge Research in English and American Studies: Language Teaching; The Intercultural Dimension of English Language Learning dhe Applied Linguistics and English Language Teaching.

Kandidati ka mbajtur një ligjëratë edhe në konferencën e nëntë të DisCo 2014, të titulluar ‘Efektet e aplikimit të gjuhës së mësuar nga MMB në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Charles-it’ në Pragë, Çeki.

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Filologjisë

PROPOZIM

Në bazë të gjithë asaj që u tha deri më tani dhe në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe në kriteret e konkursit të shpallur për personel akademik, kemi nderin dhe kënaqësinë që Këshillit Mësimor të Fakultetit të Filologjisë dhe Senatit të këtij Universiteti t'i propozojmë që kandidatin **Prof.ast.dr. Sejdi Sejdiu** ta zgjedhë mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë në titullin **profesor i asocuar** (prof. asoc. dr.) për lëndët: Përkthim anglisht-shqip; Përkthim shqip-anglisht; Teori e përkthimit; Të nxënit e gjuhës së parë dhe të dytë; Gjuhë dhe kulturë; Idiomatikë e gjuhës angleze.

ARSYETIM

1. Dr. Sejdi Sejdiu ka dëshmuar nivel të lartë të përgatitjes profesionale dhe pedagogjike që vërtetohet edhe në raportet e vlerësimit semestral dhe vjetor. Ai ka përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe poashtu përvojë në hulumtime shkencore ku me theks të veçantë ka përgatitur dhe trajnuar studentë të shumtë në fushën e hulumtimit shkencore.
2. Dr. Sejdi Sejdiu ka të publikuara një numër punimesh dhe ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme. Punimet e tij shkencore janë të indeksuara në platformat më prestigjioze në botë si Web of Science dhe Scopus. Përveç kësaj, punimet e tij citohen në masë të madhe nga autorë e shkenctarë të tjerë. Ai poashtu ka shërbyer edhe si vlerësues dhe editor senior në 'Common Ground Publishing, The Learner, University of Illinois at Urbana-Champaign'.
3. Dr. Sejdi Sejdiu zotëron titullin Post-Doc të fituar nga programi i Fulbrightit, në Universitetin Drake në Iowa, Amerikë. Libri i shkruar gjatë hulumtimit në programin e Fulbrightit është pranuar të botohet nga shtëpia botuese më prestigjioze në Evropë 'Springer'. Ndërsa disertacioni i tij i doktoratës gjendet i botuar si libër në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë, si dhe në Bibliotekën Universitare të Universitetit të Klagenfurtit.
4. Përvoja e tij në projekte ndërkombëtare me universitete vendore dhe ndërkombëtare është e pashembullt. Përmes projekteve të tij, ai i ka sjellur universitetit fonde të konsiderueshme për trajnimin e stafit në fusha të ndryshme dhe ka krijuar laboratorin e gjuhës angleze. Ai ka fituar projekte në programet Erasmus+, HERAS+, RCC, si dhe nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë. Poashtu përvoja e tij në projektet e COST




Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti i Filologjisë

Actions është motivuese për stafin akademik që të ndjekin rrugën e tij. Ai është ekzaminer me licencë ndërkombëtare të Pearson Test of English, përkthyes/interpret i lincensuar për gjuhë angleze, ekspert në nivel kombëtar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve për akreditim, lincensim dhe validim në Prishtinë dhe poashtu ka shërbyer në EAQUALS e cila është agjenci ndërkombëtare që ofron akreditim, lincensim dhe validim të institucioneve që ofrojnë gjuhë angleze.

5. Dr. Sejdi Sejdiu është i specializuar në fushën e gjuhësisë aplikative. I tërë shkollimi i tij akademik është i lidhur ngushtë me fushën e gjuhësisë aplikative. Ai ka kryer studimet e Doktoratës në Universitetin Klagenfurtit në Austri në lëmin e gjuhës angleze me notë shumë të lartë (nota 2 sipas sistemit të vlerësimit austriak). Përvoja dhe fusha e tij e studimeve përputhet më së miri me pozitën e shpallur.

Mbështetur në Statutin e Universitetit të Prizrenit, Neni 172 dhe mbështetur në kriteret e konkursit publik, ne, Komisioni Recensues kemi kënaqësinë që Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Filologjisë dhe Senatit të Universitetit në Prizren t'i propozojmë që kandidatin **Sejdi Sejdiu** të zgjedhë **PROFESOR I ASOCUAR** për lëndët: Përkthim anglisht-shqip; Përkthim shqip-anglisht; Teori e përkthimit; Të nxënit e gjuhës së parë dhe të dytë; Gjuhë dhe kulturë; Idiomatikë e gjuhës angleze.

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

- | | | |
|------------|------------------------------|---|
| 1. Kryetar | Prof. Dr. Agim Poshka |  |
| 2. Anëtar | Prof. Asoc. Dr. Arta Toçi |  |
| 3. Anëtar | Prof. Asoc. Dr. Izer Maksuti |  |

Prizren, 11 mars 2021



**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES
PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK**

Raporti i recensionit

Fakulteti: Fakulteti i Filologjisë _____
Lënda/ët: Shkathtësitë e Integruara I; Fonetikë dhe Fonologji;
Morfologji; Sintaksë e Gjuhës angleze 1; Sintaksë e
Gjuhës angleze II; Anglishte për qëllime akademike I.
Kandidati/ja: MSc. Dorinë Rakaj _____

Të dhënat mbi kandidatët:

Emri dhe mbiemri: Dorinë Rakaj _____
Datëlindja dhe vendlindja: 19.10.1990 _____
Gradat shkencore: Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë angleze; Master i
Shkencave Filologjike _____
Titujt akademikë: Asistente _____
Viti kur është fituar titulli aktual: 2018 _____
Departamenti/fakulteti: Gjuhë dhe Letërsi angleze, Fakulteti i Filologjisë _____
Universiteti: "Ukshin Hoti" Prizren _____

Komisioni recensues:

1. Kryetar Prof.ast. dr. Sejdi Sejdiu _____
2. Anëtare Prof.ast. dr. Teuta Agaj _____
3. Anëtare Prof.ast. dr. Kimete Canaj _____

Titulli akademik për të cilën shkruhet raporti:

Asistent/e (As)

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Filologjisë, Prizren

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidates Dorinë Rakaj:

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë originalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore

Vepimtaria shkencore e kandidatit	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor	1	1
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor**	2	2
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor	3	3
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor**	/	/
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor	4	4
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	1	1
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	/	/
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	/	/
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	/	/
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	/	/
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	/	/
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike	20	20
-		

Vërejtje lidhur me tabelën 1:

*Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

**Koautorë konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Filologjisë, Prizren

Punimet relevante të kandidatës

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit sidhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit të cilat tregojnë originalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	"Impact factor"	Nr. i citimeve
Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	pa "Impact factor"	Nr. i citimeve
1. <i>Professors' and Students' Perceptions of Learner Autonomy in the University of Prizren's Department of English Language and Literature. Journal of Education and Practice. 2021-Peer Review WorldCat, EBSCO</i>		
2. <i>University Students' Perception of Online Learning during the COVID-19 Pandemic: A Case Study of English Department Students at the University of Prizren "Ukshin Hoti". LangKIT2021 International Virtual Conference (6th Annual National and 3rd International Conference). 06.02.2021 Maravi, Filipine</i>		
3. <i>Conducting an Oral Storytelling workshop. 28th BETA-IATEFL Annual International Conference. May 3-5, 2019. Plodiv, Bulgaria</i>		
4. <i>Technology in Education and Learning Theory. Teachers' Avenue. 2018, Issue 07, pp. 30-33</i>		
5. <i>Teaching English Through Apps. KETNET's 8th Annual Conference: Integrating digital literacies in the English language Classroom. 02.06.2018</i> https://www.uni-pr.edu/desk/inc/media/8549297B-74AA-4BB0-9DC6-CB59BBB5B022.pdf		
